



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

V. KD. Nr. 8-3/2021

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Marigona Berisha – Kryetare, Besian Sylja dhe Rrahim Ajeti të dy anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti - Administratore në Zyrën Disiplinore në OAK, Procesmbajtëse, duke vendosur lidhur me Propozimin e ZPD-se me Nr. 72-3/2020, të datës 06.10.2021 dhe plotësim propozimit Nr.72-4/2020 të datës 18.10.2021 ndaj av. _____ me adresë në Rr. _____, konform nenit 16 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit fillestar më datën 22.11.2021, merr këtë:

V E N D I M

I. HUDHET Propozimi i ZPD të OAK-së me Nr.72-3/2020 i datës 06.10.2021 i plotësuar me date 18.10.2021.

II. PUSHOHET procedura disiplinore ndaj Av. _____ me seli të zyrës në adresën Rr. _____, për shkak të shkeljes disiplinore nga neni 118 par. 1.3 i Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 42 të KEPA-se dhe Nenit 12.1.1 të Ligjit të Avokatisë, për shkak se ka arritur afati i parashkrimit absolut për zhvillimin e procedurës disiplinore.

II. Shpenzimet e Procedurës Disiplinore bien në barrë të buxhetit të OAK-së.

A r s y e t i m

Kolegji Disiplinor i OAK-së, pas pranimit të Propozimit nga ZPD e OAK-së, e ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 13.10.2021, në përbërje të plotë. Në seancën e mbajtur të shqyrtimit fillestar Komisioni Disiplinor, pas shqimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura në Propozimin e U.D. Prokurorit Disiplinor të OAK-së, me Nr.72-3/2020, të datës 06.10.2021 me vendim ktheu për plotësim dhe korrigjim propozimin e prokurorit disiplinor meqenëse dispozitivi i propozimit nuk ishte në harmoni me nenin 13 par.2 nen par.2.4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokate dhe Praktikant duke kërkuar kështu që të saktësohet shkelja dhe koha kur është bërë shkelja disiplinore.

Me plotësim propozimit Nr.72-4/2020 të datës 18.10.2021 është plotësuar pika III e propozimit nr.72-3 të datës 06.10.2021 vetëm sa i përket datës së shkeljes disiplinore që fillon me marrjen e autorizimit me date 03.02.2017 e në vazhdimësi deri në nxjerrjen e aktvendimit Ac.nr.4495/17 nga Gjykata e Apelit me date 22.06.2020.

Zyra Disiplinore e Odës së Avokatëve të Kosovës
Rr. Bedri Pejani Nr.31, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 244 586; 038 243 717; Fax: 038 244 586

Ne seancën kryesore të mbajtur me date 22.10.2021 ne të cilën ishin prezent dhe u dëgjuan prokurori disiplinor i OAK-se, ushtruesi i fletëparaqitjes dhe av. kolegji disiplinor nga ajo që u dëgjua konstatoi se shkelja disiplinore e A... është bere kur i njëjti pas marrjes së autorizimit nga ushtruesi i fletëparaqitjes me date 03.02.2017 nuk ka ushtruar padinë për iniciimin e procedurës kontestimore në afat prej 30 ditësh siç ishte udhëzuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë. Lidhur me shkeljet e bëra në vazhdimësi, ZPD nuk ofroi prova se cilat shkelje janë bere konkretisht dhe në cilën date janë bere.

Komisioni disiplinor vlerësoj deklaratimet e të gjitha palëve prezente, dhe konstatoj se veprimet e të paraqiturit përkatësisht mos ushtrimi i padisë për të cilën ishte autorizuar përben shkelje disiplinore mirëpo për të njëjtën ka arritur afati i parashkrimit absolut ndërsa fakti se shkelja ishte bere në vazhdimësi nuk është i mbështetur në prova.

Komisioni procedoi sipas propozimit të datës 06.10.2021 të plotësuar me date 18.10.2021 dhe konstatoj se në kuptim të nenit 56 paragrafi 2 të Ligjit për Avokatinë "Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda, parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes". Në kuptim të kësaj, në këtë rast shkelja ka ndodh me datë 03.02.2017 deri me 05.03.2017 kur ka përfunduar afati 30 ditësh për paraqitjen e padisë, andaj parashkrimi absolut për këtë çështje ka arritur me datë 05.03.2019.

Nga arsyet e lartcekura dhe në mbështetje të nenit 56 par.2 të ligjit Nr.04/-193 për Avokatinë, nenit 104 par. 3 të Statutit të OAK-së, si dhe neneve 19 par.1.4, dhe 37 par. 2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikantë të dt.07.03.2020, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V. KD.Nr.8-3/2021, të dt: 22.10.2021

Procesmbajtës
Vjollca Ajeti



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 8 ditësh pranë Komisionit të Ankesave të OAK-së përmes këtij Komisioni.

Kryetari i Kolegjit Disiplinor:
Av. Marigona Berisha

